**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E EKONOMISE**
***Drejtoria e Administrimit te Prones Publike***

**URDHER**
Nr. 24 Date 1.02 2005

**PER**
**ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "PRODHIM KABLLO" SHKODER**

Drejtuar: Sh.A "Prodhim Kabllo" Shkoder

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare, neni 128, 150, VKM Nr.139, date 13.03.2003 "Per kriteret dhe proçedurat e vleresimit dhe shitjes se trojeve, me cilesine e aksionerit te vetem ,

**URDHEROJ:**

Ne aktet e themelimit te Sh.A "Prodhim Kabllo" Shkoder, te behen ndryshimet e meposhteme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet, me rivleresimin e truallit, per vleren 129,200,000 leke, i barabarte me 129,200 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.

2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Prodhim Kabllo" Shkoder te behet 938,200,000 leke i barabarte me 938,200 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
   Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.

3. Ngarkohet Drejtoria e Sh.A "Prodhim Kabllo" Shkoder per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

4. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Anastas ANGJELI

MINISTER

**RAPORT I VECANTE**
**I**

**EKSPERTIT KONTABET TE AUTORIZUAR**

**Drejtuar:Shoqerise Anonime "Prodhim Kabllo" Shkoder**

Ne, grupi i eksperteve kontabel te autorizuar,te pavarur,te perbere nga zj.Vehibe Shehu dhe Ana Osmani te ngarkuar nga Ministria e Ekonomise dhe Privatizimit me urdher Nr 214 date 22.05.2004,per pregatitjen e raportit te zmadhimit te kapitalit paraqesim si me poshte:
Pergjegjesia per rivleresimin e kapitaleve dhe pregatitjene bilancit te reformuar ne Shoqerine Anonime "Prodhim Kablllo" eshte e stafit drejtues te Shoqerise.
Eksperti Kontabel ka per detyre te beje verfikimin dhe vertetimin e rregullshmerise te procedures per rivleresimin e truallit dhe percaktimit te shteses se kapitalit themeltar si rezultat i rivleresimit te truallit ne zoterim te Shoqerise.
Ne kemi ndjekur punen e komisionit te krijuar per percaktimin e vleres se truallit ne zoterim te SH.A "Prodhim Kabllo" Shkoder.
Nga verfikimet e bera konstatuam se komisioni ka respektuar rregullat e parashikuara ne vendimin 169 date 13/03/2003 te Keshillit te Ministrave"Per kriteret dhe procedurat e vleresimit dhe te shitjes se trojeve te Ndermarrjeve Shteterore qe i nenshtrohen privatizimit ose transformimit te tyre ne Shoqeri Tregtare"

Per rivleresimin e truallit u kerku dokumentacioni i meposhtem:

- Gent-planet e Shoqerise ku eshte percaktuar siperfaqja e truallit ne zoterim te Shoqerise,e konfirmuar nga zyra e urbanistikes.
- Aktin e vleresimit te truallit ku eshte percaktuar cmimi mesatar per meter katror e konfirmuar nga Seksioni i Finances se Rrethit Shkoder.

VEHIBE SHEHU
EKSPERTE KONTABEL
E AUTORIZUAR
SHKODER

- Harten treguese te pasurise se paluejtshme e konfirmuar nga zyra e rregjistrimit te pasurive te palujtshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit te domosdoshem per rivleresim trualli u konstatua:

- Ekzistonin Gent planet ku percaktohen siperfaqet e truallit ne zoterim te Shoqerise, qe jane 85.000 m2 dhe kjo eshte e saktesuar dhe e ndare ne siperfaqe nen objekt,siperfaqe e rruge kalimeve dhe siperfaqe e lire.(lulishte e trotuare ).
- Me shkresen nr 3277 date 21/10/2004 te derguar nga seksioni i finances eshte percaktuar cmimi i truallit 2.000 leke /m2.
- Ekziston harta treguese ne te cilen shprehet pasuria e palujtshme e Shoqerise por kjo nuk eshte e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e truallit ne zoterim dhe ne inventar te Shoqerise.

Nga verifikimi i vleres se truallit ne bilancin ekzistues konstatuam se SH.A "Prodhim Kabllo"zoteronte 40.800.000 vlere truallli. Me llogaritjet e bera me cmimet e rivleresuara Shoqeria zoteron vlere trualli 170.000.000 leke.Vlera e truallit paraqet nje shtese ne shumen 129.200.000 leke,vlere e cila do te rrit kapitalin themeltar me te njejten shume.Kapitali themeltar i Shoqerise pas rivleresimit te truallit perfaqesohet nga vlera 938.200.000 leke.

**Konkluzione perfundimtare:**

Kapitali themeltar i SH.A"Prodhim Kabllo"pas rivleresimit te truallit perfaqesohet nga vlera 938.200.000 leke.

**Shkoder Tetor 2004**

**EKSPERTE KONTABEL**

**Vehibe Shehu & Ana Osmani**

VEHIBE SHEHU
EKSPERTE KONTABEL
E AUTORIZUAR
SHKODER

KONTABEL E AUTORIZUAR
ANA OSMANI
I.E.K.A.